

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi

Kuvendi i Shqipërisë miratoi emërimin e Znj. Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-shtator 2020
- Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë, janar-shtator 2020

Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim publik projektregullore për tregjet nën mbikëqyrje
- AMF publikon “Kartën e të Drejtave të Konsumatorit dhe Investitorit për tregjet nën mbikëqyrje”

Publikime Profesionale

- EIOPA publikon botimin e tretë: “Përmbledhja Vjetore e Sigurimeve në Evropë”
- IOSCO përfundon edicionin e katërt të Javës së Investitorit, WIW2020

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Bullgari
- Hungari
- Poloni
- Rumani

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi



21 tetor 2020 – Z. Ervin Mete Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe Z. Fehmi Mehmeti, Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Memorandumi i Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës thellon linjat e bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në funksion të mbikëqyrjes së integruar dhe efektive, në veçanti përmes Kolegjeve Mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të tjera.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës nënshkruan më 21 tetor 2020, një Memorandum Mirëkuptimi, në kuadër të bashkëpunimit mes autoriteteve financiare, në funksion të rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve. Memorandumi u nënshkrua në Tiranë nga z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe z. Fehmi Mehmeti, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit, z. Mete theksoi se marrëveshja e re e bashkëpunimit i përgjigjet zhvillimeve të kohës, si edhe çështjeve që kanë dalë në pah ndër vite mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.


Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës theksoi rëndësinë e bashkëpunimit reciprok mes dy rregullatorëve në adresimin e çështjeve me interes të përbashkët, në funksion të mbarëvajtjes dhe zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje.

Memorandumi thellon linjat e bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në funksion të mbikëqyrjes së integruar dhe efektive, në veçanti përmes Kolegjeve Mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të tjera.

Sa i përket tregut të sigurimeve palët angazhohen të adresojnë çështje të veçanta të mbikëqyrjes në të dy vendet, si vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikatat e dëmeve apo trajtimin dhe pagesën e dëmeve.

Në lidhje me tregjet e kapitalit, Shqipëria është në një stad më të avancuar për sa i përket kuadrit ligjor, nëpërmjet ligjeve të miratuara së fundmi, si edhe ka krijuar infrastrukturën e tregut, Bursën dhe Regjistrarin. Autoriteti është i gatshëm të asistojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në këtë drejtim. Të dy rregullatorët do të bashkëpunojnë në funksion të përmirësimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, duke iu përgjigjur zhvillimit të vazhdueshëm të tregjeve nën mbikëqyrje.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi emërimin e Znj. Mimoza Kaçi si anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Nëndrejtore Ekzekutive



The screenshot shows the AMF website header with the logo and navigation menu. Below the header is a large image of a building facade. The main content area features a news article titled "Kuvendi i Shqipërisë miratoi emërimin e Znj. Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv". To the right of the article are two buttons: "VERIFIKONI POLICËN TUAJ" and "DEPOZITO ANKESËN ONLINE". Below these buttons is the contact information for the Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, including the address, phone numbers, email, and website.

AMF - Legjislatiori - Stabiliteti Financiar - Mbrojtja e Konsumatorit - Edukimi Financiar - Regjistri i të Licencuarve - Programi i Transparencës - Publikime

Faqe Kryesore • Media

Kuvendi i Shqipërisë miratoi emërimin e Znj. Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv

VERIFIKONI POLICËN TUAJ

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
Rruga "Dora D'istria", Nr. 10, P.O. Box 8363, Tiranë, Shqipëri
+355 (0) 4 2257560, 08006969
+355 (0) 4 2250686
amf@amf.gov.al
www.amf.gov.al
E hënë - E enjte 09:00 - 16:30
E premte 09:00 - 14:00

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 7 tetor 2020, miratoi emërimin e Znj. Mimoza Kaçi në detyrën e anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të mbajë funksionin e Nëndrejtorit Ekzekutiv.

VËSHTRIM MBI TREGJET


Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-shtator 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-shtator 2020 arritën vlerën 11,999 milionë lekë, ose 6.54% më pak se në periudhën janar-shtator 2019. Gjatë periudhës janar-shtator 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 693,507 me një ulje prej 30.10% krahasuar me periudhën janar-shtator 2019.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.18% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 6.81%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.08% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.92% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5.572 milionë lekë, ose 30.27% më shumë se në periudhën janar-shtator 2019.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Shtator 2020



Gjatë janar-shtator 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5.572 milionë lekë, ose 30.27% më shumë se në periudhën janar-shtator 2019.


Zhvillimet e tregut të Titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2020

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2020, u dominua në masën 65.73% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 34.27% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 88.45% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të Titujve të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të Titujve të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2020, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 44.83% dhe 39.93% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të Titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.58% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Tregu i Titujve të Qeverisë, janar-shtator 2020 (Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të Titujve të Qeverisë, për periudhën janar-shtator 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.58% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.


Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-shtator 2020, ka pasur një ulje prej 2,038 milionë lekë ose 45.56% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Numri i transaksioneve të llojit B është ulur në masën 16.34%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-shtator 2020, ka pasur një rritje prej 7 milionë lekë ose 0.33%, ndërkohë pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 32.0%, krahasuar me periudhën janar-shtator 2019.

Në totalin e transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku, vihet re një ulje në vlerë absolute me rreth 2,062 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-shtator 2019.

ZHVILLIME TË TJERA



□ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren **“Për administrimin e riskut nga shoqëria administruese e fondeve”**. Projektregullorja është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit për konsultim publik në datën 02.10.2020 dhe më pas është miratuar në mbledhjen e Bordit të datës 23.10.2020.

□ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren **“Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve”**. Projektregullorja gjendet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=55>




□ Në funksion të mbrojtjes konsumatore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare **“Kartën e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”**.

Kjo Kartë përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e AMF-së dhe ligjeve specifike, që rregullojnë secilin nga tregjet financiare jobankare.

“Karta e të Drejtave” gjendet në faqe në linkun:

https://amf.gov.al/karta_e_t%C3%AB%20_drejtave.asp

Në funksion të mbrojtjes konsumatore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare “Kartën e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”.



EIOPA publikon botimin e tretë të “Përmbledhjes Vjetore të Sigurimeve në Evropë”

<https://www.eiopa.europa.eu>

Autoriteti Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale, EIOPA, publikoi në tetor 2020 “Përmbledhjen Vjetore të Sigurimeve në Evropë”. Materiali i publikuar është një përmbledhje e lehtë për t'u përdorur mbi ecurinë e sektorit evropian të sigurimeve. Raporti bazohet në informacionin vjetor të raportuar në kuadër të *Solvency II*. Kjo siguron që të dhënat të kenë një shtrirje të gjerë në mjaft vende që i përkasin Zonës Ekonomike Evropiane.

Raporti është objektiv dhe i plotësuar me të dhëna sasiore. Ai nuk përmban analiza apo mesazhe politike. Të gjithë treguesit e përdorur në raport janë llogaritur nga të dhënat e raportuara nga entitetet në tregun e sigurimeve. Megjithëse tematikat dhe treguesit e pasqyruar në këtë publikim synojnë të jenë relativisht të qëndrueshëm me kalimin e kohës, raporti i përgatitur do të përshtatet për t'iu përgjigjur ndryshimeve në përparësitë mbikëqyrëse dhe mikroprudenciale. Raporti do të shërbejë si një mbështetje për autoritetet mbikëqyrëse dhe industrinë e sigurimeve me të dhëna mjaft të rëndësishme në nivelin evropian.

IOSCO përfundon edicionin e katërt të Javës së Investitorit, WIW2020

<https://www.iosco.org/>

Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Titujve (IOSCO) zhvilluan edicionin e katërt të Javës së Investitorëve (WIW 2020) nga 5 deri më 11 tetor 2020. Më shumë se 100 vende anëtare të IOSCO dhe organizata të tjera morën pjesë në këtë javë me synimin për të promovuar edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve, jo vetëm në periudhë afatshkurtër, por që këto përpjekje dhe efekti i tyre të shtrihet në një kohë më të gjatë.

WIW 2020 përcolli kujdesin që duhet të kenë investitorët lidhur me rrezikun për të investuar në tregjet e paqëndrueshme të shkaktuara edhe nga pandemia. Fushata e këtij viti u përqendrua edhe në elementët bazë për të bërë investime inteligjente, si edhe të kuptuarit e rreziqeve nga investimi. Fushata përsëriti edhe një herë mesazhet e vitit të kaluar në lidhje me investimet në internet dhe asetëve digjitale. Me më shumë pjesëmarrës së vitet e kaluara, WIW 2020 theksoi rëndësinë e rritur të edukimit e mbrojtjes së investitorit, sidomos në kushtet e pandemisë COVID-19.

Faqja *online* e dedikuar “Javës së Investitorit 2020” është www.worldinvestorweek.org



Normat e ulëta të interesit lënë më pak mundësi të mira për kursimet

<https://www.economist.com>

Finance & economics

Oct 17th 2020 edition >

The saver's dilemma

Low interest rates leave savers with few good options

The covid-19 pandemic has only sharpened the dilemma



Individët që duan të kursejnë në të gjithë botën përballen me të njëjtin problem. Çfarë të përdorin: llogaritë bankare, apo fondet e përbashkëta të tregut të parave dhe instrumente të tjerë afatshkurtër të përdorur për të ofruar një kthim të denjë të investimeve dhe kursimeve të tyre? Normat e interesit janë më të ulëta në terma nominalë sesa ishin 30 vite më parë për shkak të një rënieje afatgjatë të inflacionit, por gjithashtu ato janë më të ulëta edhe në terma realë. Pandemia e ka bërë akute dilemën. Këtë vit *yield*-i nominal i bonove dhjetë vjeçare amerikane, britanike dhe gjermane kanë prekur nivelet e tyre më të ulëta në histori.

FMN parashikon që ekonomia botërore do të vuajë nga “Covid-i zgjatur”


<https://www.economist.com>

Finance & economics

Oct 17th 2020 edition >

The IMF predicts that the world economy will suffer from “long covid”

Some lost growth will not be recovered



Parashikimet e fundit të FMN-së, të publikuara në 13 Tetor, tregojnë se sa kohë do të zgjasë dëmi ekonomik nga Covid-19. PBB-ja e SHBA-ve do të kthehet në nivelin e saj të vitit 2019 vetëm në 2022; Italia, në 2025. Fondi llogarit që në shumë vende prodhimi do të qëndrojë shumë poshtë trendit të tij para-pandemik, pasi fuqia punëtore dhe kapitali rialokohen ngadalë nga industritë e turrjes drejt atyre të lulëzuara. Tetorin e kaluar FMN priste që ekonomia e Indisë të rritej me më shumë se 40% deri në vitin 2024; tani pret gjysmën e kësaj.

BOSNJE-HERCEGOVINA

www.xprimm.com

Duke filluar nga 19 tetori, polica ndërkombëtare e sigurimit motorik "Kartoni Jeshil" nuk do të jetë e nevojshme për automjetet e regjistruara në një nga vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (*European Economic Area, EEA*) për të hyrë në territorin e Bosnje & Hercegovinës (BiH), ose për automjetet e BiH për të qarkulluar në rrugët e vendeve të EEA.

Ky thjeshtim është rrjedhojë e nënshkrimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe të Garancisë midis Zyrave Kombëtare në bazë të targës së regjistrimit. BiH aderoi në "Nënsistemin e Targave" (*License Plate Subsystem*) që përfshin 33 shtete anëtare të BE-së, si dhe Zvicrën, Lihtenshtejnin, Andorën, Islandën, Norvegjinë dhe Serbinë.

Në njoftimin për shtyp në faqen e internetit të Byrosë së Kartonit të Jeshil të BiH theksohet se "... pas shumë vitesh përgatitje dhe pune për vendosjen dhe përbushjen e kriterëve dhe standardeve të caktuara nga Komuniteti Evropian i Siguruesve në Bruksel, Byroja e Kartonit Jeshil në Bosnjë-Hercegovinë nënshkroi një Marrëveshje Garancie shumëpalëshe, me të cilën Bosnje-Hercegovina u bë anëtare e asaj që quhet "nënsistem i targës".

Për një kohë të gjatë, BiH nuk mund të pranohej në "Nënsistemin e Targave" sepse përqindja e automjeteve të paregjistruara në rrugët e saj kalonte 5%.

BULLGARI

www.xprimm.com

Shifrat e publikuara nga Komisioni Bullgar i Mbikëqyrjes Financiare, FSC, tregojnë se tregu i sigurimeve në vend në gjysmën e parë të vitit 2020 pësoi një rënie me rreth 2% të vëllimit të primeve të shkruara bruto, duke arritur në 1.44 miliardë BGN (monedha lokale) ose 740 milion euro.

Segmenti i primeve të shkruara bruto në tregun e Jo-Jetës zinte 84.28% të vëllimit total të primeve duke arritur në 623 milionë euro ose 0.65% më shumë se vjet. Ndërsa pjesa tjetër prej 15.72% ishin prime në sigurimet e Jetës, prej 116.33 milionë euro ose me një rënie prej 14.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave për tregun e sigurimeve të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, MNB, të ardhurat nga primet e shkruara bruto në sektorin e sigurimeve, për gjysmën e parë të vitit 2020 arritën në 613 miliardë HUF (monedha lokale) ose 1.72 miliardë euro. E shprehur në monedhën vendase, tregu pati rritje me 3.65% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të ardhurat në tregun e sigurimit të Jetës u rritën me rreth 0.59%, duke arritur në 259.4 miliardë HUF. Edhe tregu i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit duke arritur në 353.69 miliardë HUF. Rreth 42.31% e të ardhurave nga primet vijnë nga biznesi i sigurimeve të Jetës dhe 57.69% nga biznesi i sigurimeve Jo-Jetës.

Në fund të qershorit 2020, numri i përgjithshëm i kontratave të shoqërive të sigurimeve ishte 1.36% më i lartë se niveli i një viti më parë për të njëjtën periudhë. Kjo rritje ishte më e ndjeshme në numrin e kontratave të sigurimeve të Jo-Jetës. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës ra me 1.77% duke arritur në 2.348.786.

POLONI

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Poloni pësoi një rënie prej 6.7% gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 7.05 miliardë euro në fund të qershorit 2020. Rënia e primeve ishte e ndarë thujtë në mënyrë të barabartë midis segmenteve të tregut të Jetës dhe Jo-Jetës. Megjithatë, duke pasur parasysh zhvlerësimin rreth 5% të monedhës polake kundrejt euros, rezultatet e tregut të sigurimeve të shprehura në monedhën vendase duken më mirë, duke treguar një rënie prej 2% të vëllimit të primeve të shkruara bruto.

Primet në tregun e sigurimit të Jetës, mbetën afër nivelit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, me ulje prej vetëm 4.5% në monedhën vendase (ose 9% në euro). Pjesën më të madhe në rënieën e biznesit të sigurimeve të Jetës e luajtën produktet *Unit Link*, të cilët patën një rënie prej 18.6% në terma vjetorë. Sidoqoftë, duhet shënuar se përfitimet e paguara për këto polica sigurimi u ulën me rreth 16%, duke treguar se klientët ende i shohin këto produkte si një investim afatgjatë.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, Sigurimi i pronës ishte ndër të vetmet sigurime që patën rritje, e nxitur kjo nga klasa e sigurimit nga zjarri. Klasat e sigurimeve motorike panë një dinamikë negative. Nga ana tjetër, kompensimi për humbjet në bujqësi u rrit, si pasojë e ngricave të pranverës.

RUMANI

www.xprimm.com

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, tregu i sigurimeve në Rumani arriti vëllimin e primeve të shkruara bruto prej 5.6 miliardë RON (monedha lokale) ose 1.2 miliardë euro. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, kjo shifër paraqet një rritje të primeve me 3.5% më shumë e shprehur në monedhën vendase (ose 1.2% më shumë e shprehur në euro). Edhe dëmet e paguara u rritën, duke arritur në 3.3 miliardë RON (rreth 691 milionë euro), ose 1.5% më shumë e shprehur në monedhën vendase, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i primeve të shkruara bruto sipas sektorëve të Jetës dhe Jo-Jetës ka anuar në favor të sektorit të Jo-Jetës, si një pasojë e drejtpërdrejtë e rënies prej 4.2% e primeve të Jetës dhe rritje prej 5.4% e primeve të Jo-Jetës. Rreth 19.2% e totalit të primeve erdhën nga klasat e sigurimeve të Jetës, ndërsa pjesa tjetër, rreth 80.8% erdhën nga klasat e sigurimeve të Jo-Jetës.

Klasat e sigurimeve motorike, MTPL dhe sigurimi Kasko, vijuan të zënë pjesën më të madhe të tregut, prej 56.5% të vëllimit total të primeve për të dy këto klasa. Primet e shkruara bruto të sigurimeve motorike u rritën me 2.2%, një rezultat befasues duke marrë parasysh kufizimet e lëvizjeve të vendosura nga Qeveria si pasojë e pandemisë, e cila boshatisi bulevardet kryesore të vendit.

Sigurimet e pronave, grupi i dytë më i madh nga segmenti i tregut të Jo-Jetës, u rrit me 7.7%, duke përfshirë rritje në sigurimet nga zjarri dhe rreziqet shtesë si edhe dëmet e tjera në pronë.

Në fund të qershorit 2020, numri i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve që vepruan në Rumani ishte 27. Nga ky numër, 14 shoqëri janë të specializuara në sigurimin e Jo-Jetës, 7 janë të specializuara në sigurimin e Jetës, ndërsa 6 prej tyre ishin aktive si në sigurimet e Jetës, ashtu edhe në ato të Jo-Jetës.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al